



## PROCESVERBAL II/2023

**I mbajtur me rastin e mbledhjes së 2 (dytë) për vitin 2023 të Kuvendit të Komunës së Suharekës**

---

Vendi: Suharekë  
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës  
Data: 28.02.2023  
Ora: 10.00

---

**Prezentë në takim:**

Z. Shefket Kolgeci

Z.Selman Kolgeci

Z. Flamur Bytyqi

Z. Urim Suka

Z. Kushtrim Kuçi

Znj. Elmaze Bytyqi

Znj. Bulëza Kuçi

Znj.Doruntina Zenelaj

Z.Alban Berisha

Z. Bexhet Kuçi

Z. Reshat Selimaj

Z. Lirim Qatani

Z. Aziz Bytyqi

Znj.Sanie Kuçi-

Rexhepaj

Znj.Besa Kuçi

Znj.Fidaije Kukaj

Znj. Afërdita Morina

Z. Enver Shabani

Z. Vullnet Luzhnica

Z. Xhevshet Gashi

Z.Edon Sadikaj

Z.Dardan Berisha

Z.Bajram Basha

Znj.Mevlude Kabashi

Znj.Sheqerije Zyrapi

Znj.Laureta Tafaj

Z.Liridon Fandaj

Z.Qëndrim Elshani

Znj.Festë Kabashi

Z.Herolind Limaj

Znj. Jehona Rrafshi

Të pranishëm të tjerë

Kryetari Komunës

Media dhe qytetarë  
OSCE, LMT, KDI  
Znj.Habibe Bytyqi  
Z.X heladin Sadika

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,i cili propozoi këtë:

### ***REND DITE***

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-statutit të bibliotekës së qytetit „Hajdin Berisha“ në Suharekë;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-12153 të datës 28.02.2022 i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimin 01-Nr-016-25493 i datës 28.04.2022;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit rregullues të Hollësishëm për zonën industriale Shirokë;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit rregullues të Hollësishëm për zonën industriale Biraq;**
- 6. hqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit rregullues të Hollësishëm për fshatin Delloc;**
- 7. Shqyrtimi i projekt-Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Suharekës;**
- 8. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave për Komunën e Suharekës për periudhën 2023-2027;**
- 9. Pyetje dhe përgjigje;**

**Kryesuesi** - e hedh në votim rendin e ditës.

**Unanimisht Miratohet**

#### **Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**Urim Suka** - në këtë procesverbal kemi disa vërejtje.Nëse mundet një vëmendje pak ma e madhe sepse në disa raste shumë mendime janë tjetërsu dhe nuk janë paraqit fare, sidomos nga fundi i mbledhjes.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën e parë me vërejtjen që u tha.

**Unanimisht Miratohet**

#### **Pika 2. Shqyrtimi i projekt-statutit të bibliotekës së qytetit „Hajdin Berisha“ në Suharekë;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Kushtrim Kuçi** -ne si LDK e përkrahim këtë iniciativë por desha të kthehem në retrospektiv.Në seancën e parë unë kam reagu për statutin e bibliotekës dhe nese e mbani mend ekziston inqizimi, procesverballi, dhe reagimi i Kryetarit dhe zyrtarit ligjor ka qenë që statuti ka përfundu.E tash,tek një vit e mbas po del që s’paska përfundu para një viti e gjysmë.Ju kisha lut herave tjera të jeni më të vëmendshëm.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 2.

**Unanimisht Miratohet**

**Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-12153 të datës 28.02.2022 i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimin 01-Nr-016-25493 i datës 28.04.2022;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Qëndrim Elshani** - ne mendojmë që projekt-vendimi për kompetenca shtesë të komisionit për ndarjen dhe definimin e banesave dhe lokaleve afariste është në kundërshtim me ligjin për vet qeverisje lokale në nenin 40 paragrafi 40.2. Kërkojmë nga gjithë anëtarët e Kuvendit që mos të votohet kjo pikë dhe nëse ky vendim kalon LVV do ta shqyrtojë mundësinë e tërheqjes së anëtarës së saj nga ky komision.

**Selman Kolgeci** - nuk e kam të qartë se si një vit pas këtij projekt-vendimi po ju bie në mend që duhet me shtu edhe një pikë në këtë. Edhe mandatin e kaluar ka qenë ky problem. Pse është zvarrit deri tash?

**Kryesuesi** - problem ka qenë te pala sepse kanë qenë të pakënaqur në disa raste deri sa e kanë prezantuar dokumentin që e kanë të blerë atë objekt, prej dy lokaleve dhe tash kërkojnë me fut këtu.

**Visar Kuçi** - si pikë është vonu por jo me fajin tonë. Ne si komision kemi qenë të gatshëm me përfundu atë proces, ku edhe komisioni i kaluar ka bërë një punë shumë të mire. Pala është pajtuar por çdo herë ka kërkuar zgjidhje për sipërfaqet e blera që i ka.

**Selman Kolgeci** - y problem, a ka dal tash apo ka qenë problem edhe mandatin e kaluar? Me sa kam informata, kjo kërkesë ka qenë edhe mandatin e kaluar.

**Visar Kuçi** - kur është përfunduar puna nga komisioni, pala atëherë e ka paraqit këtë kërkesë.

**Urim Suka** - E para, për këtë çështje që po flasim ekziston një kontratë që ka lidhë Komuna me përfaqësuesit që kanë me bo ndërtimin dhe ne që po e marrim një vendim me ia dhënë këtë kompetencë shtesë komisionit. A ka implikime ky vendim te kontrata dhe a duhet të bëhet kontratë e re? E dyta, ne po i japim detyrë komisionit dhe detyrë e komisionit është ta bëjë barasvlerën e ndërrimit të pronave. Kisha kërku nga ky komision që formohet, të kërkoj një vlerësim profesional nga një kompani e licencuar dhe që e bën barasvlerën dhe me u thirrë pastaj në atë, sepse ne si asambleist ndoshta ndonjëri mundemi me qenë i asaj fushe por të gjithë nuk mund të jemi ekspert të asaj fushe. Si çështje teknike ndoshat është mire me kalu por kërkoj sqarime sidomos te pjesa e implikimit me kontratë.

**Avni Bytyqi** - është proces që ka fillu në 2017 e këndej. Në 2019 e kemi nënshkru një kontratë me Bashkim Hoxhën, Sami Elshanin dhe Komunën me të cilën kontratë kemi parapa që të themelohet një komision nga Kuvendi prej 5 anëtarëve me qëllim të kompenzimit të pjesës së Komunës që i takon në pjesën ku është duke u ndërtu objekti në pronë publike. Mirëpo pastaj kanë lindur disa defekte për të cilat është konstatu se Bashkim Hoxha i ka dy banesa të ndërtuara në pronën publike dhe ne pas kësaj periudhe e kemi konstatu me kontrata që personi në fjalë i ka këto dy objekte dhe ne e kemi obligim ligjor që t'ia kompenzojmë sipërfaqen e banimit. Komisioni që e ka bërë vlerësimin ose kompenzimin e pronës publike me pronën private nuk ka pas detyra shtesë apo përgjegjësië t'ia jep dhe këtë të drejtë Bashkim Hoxhës. Ne përmes këtij vendimin kërkojmë që ti japim detyrë shtesë komisionit, që ta bëjë vetëm kompenzimin.

**Alban Berisha** - duke e pas prasysh se me sa punëpozitet flitet gjithmonë, një Komunë, një administratë që vazhdon me procedura të shpejta. Si ka mundësi një marrëveshje mos të realizohet për katër vjet për një parcelle shumë të vogël në krahasim me çfarë parcela, me hektar që kemi dhënë? Nuk kisha pas dëshirë që në Komunën tone me ndodhë që të zvarriten kaq shumë çështjet sepse kjo është e tepërt. Dikush e merr lejen dhe brenda një viti ne e shohim që u ndërtu një banesë. Nuk jam kundër atyre që ndërtojnë. Edi që kanë dal fakte të reja dhe e zvarrisin procesin. Por, a ka qenë edhe ekzekutivi ekspeditiv në realizim të kësaj detyre? Unë mendoj që nuk ka qenë. Shpresoj dhe uroj që është një dështim pa qëllim.

**Qëndrim Elshani** - ky ndërtim që po kompenzohet mëtej për mëtej, a ka leje ndërtimi?

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - pasi jam e vetmja anëtare në këtë komision, që kam qenë anëtare në komisionin e kaluar dhe mandatin e kaluar, kjo çështje është zhagrit por për mendimin tim nuk është faji aspak i komisionit dhe aq më pak i ekzekutivit për arsye se ne punën tone jemi mundu ta bëjmë maksimalisht. Kontrata në 2019 është nënshkru mirëpo investitori ka pas me iu parashtru kërkesave për kushte dhe leje ndërtimore, e që kanë zgjat për shkak të vet pales deri sa i ka sjellë dokumentacionet e kompletuara. Leja ndërtimore nuk është lëshuar për shkak se në bazë të kontratës leja lëshohet pas arritjes së marrëveshjes që miratohet në Kuvendin Komunal. Sanie Kuçi Rexhepaj tutje jep sqarime.

**Qëndrim Elshani** - falemderoj Sanien për përgjigjen por e kam fjalën për objektin ekzistues.

**Visar Kuçi** - objekti ekzistues ka leje ndërtimi.Kur z. Hoxha e ka ble objektin, ka qenë banim dhe prej banim e ka kthyer në lokal afrikt të përkohshëm.Ne si komision do të shqyrtojmë të gjitha dokumentet,do ta bëjmë një raport dhe do ta bëjmë në Asamble.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 3.

**28 për, 2 apstenime**

**Miratohet pika 3**

#### **Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit rregullues të Hollësishëm për zonën industriale Shirokë;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Selman Kolgeci**- para se të vendoset për iniciimin e planit rregullues të hollësishëm për Z.Industriale në Shirokë,mendoj që do të duhej që anëtarëve të Kuvendit ti prezantohet një raport i gjendjes ekzistuese.Sa biznese janë shfrytëzues të parcellave në zonës ekonomike,sa janë aktive,a është ndonjë biznes në procedurë për me iu marrë parcela nga gjykata,sa parcella janë të lira,a parashihet zgjerimi i Z.Industriale në Shirokë dhe nëse po, në cilën pjesë parashihet,një zgjerim i tillë dhe a është në harmoni me PZHK-në dhe a është ndërru destinimi i parcellave.Me arsyetimin që e ka dhënë Drejtorja e Urbanizmit,është thënë që ky plan i hollësishëm është i nevojshëm pas miratimit të HZK-së,pa treguar se a do të ketë ri organizim të destinimit.Ne do ta mbështesim iniciativën për planin rregullues të hollësishëm në Shirokë por kemi rezervat tona sepse si qeverisje keni dëshmuar disa herë që mungon ekspertiza e mjaftueshme për të hartuar plane të tilla dhe si pasojë e kësaj besoj që edhe tani po shihni problemet në implementimin e HZK-së.

**Kryesuesi** - sa i përket raportit ne shpresojmë që muajin e ardhshëm Drejtorja e Urbanizmit ka me sjell një raport.

**Visar Kuçi**- ai kërkoi raport për Zonën dhe sa i përket Drejtorisë së Urbanizmit nuk është kompetencë për atë raport edhe pse do të na kishte shërbyer shumë gjatë hartimit të planit të ri rregullativ.

**Selman Kolgeci** -Drejtorinë e Urbanizmit e përmenda për arsyetimin që e ka dhënë.

**Visar Kuçi** - është në harmoni me PZHK-në dhe HZK-në dhe pak a shumë kemi dhënë sqarime edhe në materialin që e kemi dërgu.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - plani rregullues i Z.Industriale është shumë i nevojshëm për me u hartu dhe me u miratu nga ana jonë.Gjatë hartimit të PZHK-së dhe HZK-së atëherë si pjesë e Komunës jemi mundu që këtë plan me inkorporu në HZK identik siq është,që mos me pas nevojë me hartu një plan të ri për arsye se Z.Industriale në Shirokë është pothuaj tërësisht e ndërtuar dhe vet Ministria na ka sjellë në këtë fazë sepse na ka kushtëzu që nese doni që HZK të miratohet duhet të shfuqizohen të gjitha planet rregullative dhe ne vet si Kuvend e kemi marrë atë vendim.Kërkoj nga ana e Komunës që me e shqyrtu mire gjendjen ekzistuese për shkak se ndoshta nuk përputhet qind për qind me planin rregullues.

**Qëndrim Elshani** - ne si grup i LVV-së nuk mund të votojmë për këtë pikë pasi që nuk e kemi pa planin.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 4.

**27 për,2 apstenime**

**Miratohet Pika 4**

#### **Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit rregullues të Hollësishëm për zonën industriale Biraq;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Selman Kolgeci** - Drejtorja e Urbanizmit nuk ka dhënë asnjë arsyetim se cilat janë kërkesat e tregut dhe çfarë destinimi ka ajo zonë.Kryetari e ka reklamu dhe tash po e kërkon iniciimin për ti nisur procedurat. Me sa e di, është një projekt i përfunduar për atë zone.Ne do ta mbështesim iniciimin për këto procedura por shpresoj mos të jetë projekt i fushatës të stilit tuaj.

**Visar Kuçi** - si zonë është e paraqitur edhe në PZHK dhe në HZK për Z. Industriale. Sipërfaqja përafërsisht është mbi 110 ha duke përfshirë edhe varrezat e fshatit Bllacë. Vendi i quajtur është Biraq, zona kadastrale është në Bllacë. Drejtori tutje jep sqarime.

**Selman Kolgeci** - cilat kanë qenë kërkesat e tregut për zonën? Cili ka me qenë destinimi brenda asaj zone **Visar Kuçi**- ne e kemi paraqitur si plan rregullativ me hartu në PZHK dhe HZK. Deyrë e jona është me bo planin rregullativ dhe ne do të bashkëpunojmë me drejtoritë sektoriale dhe do të harmonizojmë kërkesat.

**Selman Kolgeci**- ne e dim që ka kërkesa dhe Z. Industriale në Shirokë është mbush dhe nevoja është për tu zgjeru. Së paku duhet ti keni këto informacione bazike.

**Urim Suka** - unë e kam pak a shumë të pjesa procedurale dhe vendimin që ne duhet ta marrim, por në parim e mbështesim çdo inicim të planeve rregulluese. Unë i kam ngritur disa tema në KPF dhe ajo që dua të them është se kur po na sillni projekt-vendimet, kam dëshirë me na ardhë edhe një raport ose Drejtori të na bëjë një prezantim pak më të hollësishëm se për çka po flitet, sepse shumica e asambleistëve nuk janë profesionist të fushës. Nëse nuk je profesionist fushës e ke të vështirë me pas një përceptim dhe disa prej asambleistëve po detyrohen me votu përmendësh.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 5.

**27 për, 3 apstenime**  
**Miratohet pika 5**

#### **Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për inicimin e procedurave për hartimin e Planit rregullues të Hollësishëm për fshatin Delloc;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin. Nuk ka debat, e hedh në votim.

**25 për, 3 apstenime**  
**Miratohet pika 6**

#### **Pika 7. Shqyrtimi i projekt-Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Suharekës;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Urim Suka** - lidhur me rregulloren për menaxhimin e mbeturinave për tërë territorin e K. Suharekë, ne si LDK vlerësojmë se çdo rregullore në parim është e mire dhe e mbështesim secilën përpjekje që këto çështje të rregullohen me rregullore të veçanta me qëllim të funksionimit sa më të mire të tyre. Në emër të kuvendarëve të LDK-së dua të paraqes një propozim konkret të cilin e kam ngritur edhe në KPF. Ne si LDK propozojmë që tarifa mujore për njesitë familjare të mbetet siq ka qenë 4.5 euro dhe jo siq propozohet në këtë projekt-rregullore në 6 euro. Duke qenë të vetëdijshëm për rritjen e kostos së këtij shërbimi, ne mendojmë që të paktën për një periudhë një vjeqare të mos rritet çmimi për njesi familjare. Komuna të analizojë mundësitë që ka për ta subvencionuar dallimin prej 1.5 eurove apo të gjej formë të tjera për ta zgjidhur këtë çështje dhe të mos ngarkohen qytetarët në këtë kohë të rënduar ekonomike. Ne e mbështesim këtë projekt rregullor nëse merret parasysh propozimi jonë, në të kundërtën votojmë kundër.

**Kryesuesi** - për mendimin tim, një rritje prej 1.5 euro për një muaj nuk është shumë. Duhet të mendojmë pak edhe për ata puntorë që punojnë gjithë ditën, që edhe ata duhet të kenë një ngritje të pagës dhe duke i llogaritur kostos e rritjes për tonë në hudhjen e mbeturinave, mendoj që nuk është shumë.

**Qëndrim Elshani** - pajtohem që duhet me iu rrit paga personave që punojnë në këtë drejtim por njëkohësisht e kundërshtoj atë që thotë, që janë ngritur çmimet e derivateve. Janë ngritur për një kohë por tash e dime që kanë ra çmimet e derivateve dhe duke shprehur faktin që janë rritur çmimet në secilin sektor, unë mendoj që është e papranueshme dhe është rritje e madhe.

**Kryesuesi** - kjo do të implementohet nga 1 janari i vitit 2024.

**Kushtrim Kuçi** -unë personalisht kam qenë pjesë e këtij komisioni dhe ajo që më ka shqetësuar ditën e pare,përfaqësuesi i Eko Regjionit,që ditën e parë shqetësim e ka pas vetëm çmimin e naftës.Tani nafta ka rënë dhe nëse e rrisim çmimin,a kanë me u rrit shërbime?

**Kryesuesi** - po sepse janë duke i zgjeru sipërfaqet që i menaxhojnë.

**Kushtrim Kuçi** - dhe rriten besoj edhe rrogat e punëtorëve.Me 4.5 euro ata kanë thënë që i mbulojnë pagat e punëtorëve dhe gjithmonë ka mbetje të buxhetit.

**Enver Shabani** -tema që diskutojmë është në interes të përgjithshëm,pra të qytetarit dhe ambientit. Ngritja që po ndodh prej 1.5 euro për ekonomi familjare,unë besoj që nuk e ngarkon gjepin e qytetarit.Në punimin e kësaj rregullore ka qenë një grup punues ku kanë qenë aktiv të gjithë por ne e falemderojmë gjithëashtu Organizatën qeveritare Japoneze që ka punu në vazhdimësi. Për formimin e kësaj rregullore ka qenë e kontraktuar një kompani private ku sot është prezente avokatja që ka përfaqësuar këtë kompani. Jo vetëm që do të rriten pagat për punëtorët dhe të rriten shërbimet,mbulueshmëria për grumbullimin transportimin dhe menaxhimin e mbeturinave është rreth 95 % kurse inkasimi rreth 80 %.Ka 23 vite që Eko Regjioni funksionon me punëtorë,ata përveq pagave nuk arrijnë të zhvillohen më shumë.Deri më tani i kanë marrë 4 kamionë nga Organizata Japoneze donacione dhe 2 nga Gizi gjerman për performancë të mire.Drejtori tutje jep sqarime.

**Qëndrim Elshani** - realisht neve po na bie dy here të paguajmë.Një herë kur po tenderohet dhe një herë si qytetarë e dikush që ka biznes tri herë apo më tepër.Drejtori po e quan rrije të lehtë e që në përqindje i bie rreth 35 %.A po i rriten pagat punëtorëve apo po blejmë kamion me këto para?Kush na siguron neve që kanë me iu rrit pagat punëtorëve?Nëse rriten pagat e punëtorëve për 35 %,ne po votojmë pro.A ka vende tjera në regjion që e kanë marrë një hap të tillë apo ne jemi të vetmit?Këto të mira materiale a shkojnë vetëm për shërbime në K.Suharekës apo alokohet në buxhetin e përgjithshëm të Eko Regjionit?

**Kryesuesi** - drejtori e tha që komunat tjera e kanë miratu këtë rregullore,janë katër nëse nuk gaboju.

**Enver Shabani** - në regjion jemi të parët kurse inkasimi ka me shku në komunë dhe kompania ka me marrë me tender ose me marrëveshje.

**Flamur Bytyçi**- drejtori tha që nesër mundet me apliku edhe një kompani tjetër për me marrë.Pse me ngrit ne çmimin,për deri sa ne nuk e dim a kemi me ja rrit rrogat kompanisë në fjalë apo një kompanisë tjetër private që ka me marrë?

**Enver Shabani** -tash për tash nuk janë duke punu me humbje por nuk kanë asnjë ngritje ekonomike. Andaj çdo kompani tjetër që vje ,nuk vje me 4.5 euro në muaj dhe përveq rrogave ata duhet me u zhvillu si kompani edhe me asetë të tjera.

**Elmaze Bytyqi** - te rastet sociale a mundemi me i lënë me 4.5 euro?

**Enver Shabani** - të gjitha janë të klasifikuara,rastet sociale,gurbetqarët,një person në familje.

**Aziz Bytyqi** -praktikisht qytetarët në bazë të sqarimeve që morën janë të kënaqur përgjithësisht me shërbimet e tyre, me që inkasimi është mbi 80 %. Jemi në një situatë ku kemi inflacion dhe natyrisht është rrit kosto e shërbimeve për ta.Qështja e pagave është çështje e menaxhmentit të brendshëm.Shefi i grupit të LDK-së e ndryshoj qëndrimin sepse kërkesa e tij ishte që deri me 31 dhjetor të shkojnë me këto çmime ndërsa prej 1 janarit të bëhet ngritje dhe kur e pa që jemi njëjtë në këtë pikë,dëshira për me qenë i ndryshëm,e shtoj.

**Shefket Kolgeci** -unë mendoj që qeveria lokale nuk po përdor kutin e njejtë në çdo aspekt.Drejtori tha që i kanë bërë katër komuna dhe dy i numëroj dhe të tretën e të katërtën nuk e gjet në regjion asnjë.Taksa komunale nuk paguan as Prizreni,as Malisheva etj.A nuk po e merrni atë, që ata nuk po paguajnë dhe nuk do të paguajmë edhe ne.Këtu kanë pagu dy komuna,të paguajmë edhe ne.Kah po i bje interesi i qeverisë, po i ndërroni kahjet.Taksën komunale e kemi pas në Asamble,kemi dalë me votu dhe na keni mbi votu.Pse ta denojmë qytetarin?Të presim Prizrenin dhe nëse e shofim që nuk po mund të mbijetojë Eko Regjioni,ne kemi me ngrit.Unë mendoj që me këtë ngritje inkasimi ka me ra 50%.Andaj qeveri, ju lutem,ne duhet ti mbrojmë qytetarët sepse është krizë e jashtëzakonshme ekonomike dhe ne duhet ti mbrojmë qytetarët. Nëse ka nevojë mi ndihmu Eko Regjionit,gjeji mjetet,silleni në Asamble,arsyetoji që nuk ka mjete dhe ne do ta votojmë me i ndihmu atyre punëtorëve por edhe me ble ndonjë makinë.

**Kryesuesi** - doktori,edhe vitet e 90-ta,edhe në luftë, Suhareka gjithmonë ka qenë e para.

**Alban Berisha**-Dua të jap një vërejtje Kryesues.Në zyren tënde a e ke këtë ambient ? Sepse kam vërejtje për kushtet e Asamblesë.A po lëshohen nxemjet pak para se të nis seanca apo çka është në pyetje?Duke e pas parasysh që në të gjitha shërbimet janë duke u rrit çmimet,mundet me qenë edhe e arsyeshme.Drejtor, a e keni bërë një analizë të saktë se a i kemi shërbimet fikse për këto çmime ekzistuese që janë sot?Për dikënd kjo shumë mundet me qenë e lirë krahas shërbimeve.Personalisht për mua çmimi nuk është i shtrenjtë por shërbimi nuk e meriton atë çmim.Drejtor, a i sheh nëpër lagje kontinierat si janë të stër mbushura?Po i bëni 6 vjet mandate dhe publikisht njiheni nëpër media dhe qytetarë të komunnave tjera na kanë zili për Kryetarin Bali Muharremaj se sa shumë bën për pastërtinë.Është e vërtetë që për Brigadën 123 e ka 10-she.Në cilën lagje ekziston këndi i mbetuerinave nëpër lagje?Më e mira është që më shumë me investu në vetëdijësimin kolektiv,me bo programe stimuluese për qytetarë që të klasifikohen mbeturinat.Kanë kosto dhe këto po i them për shkak të kompozitetit medial që i keni në aspektin e menaxhimit të mbeturinave,që për mua nuk është e vërtetë.Ata punëtorë, a e din sa hekin me shumicën e kontinierave në Suharekë me i vendos në ato kamiona për me i hudhë ato mbeturina sepse janë gjysma-gjysma kontinierat.

**Kryesuesi** - pikërisht për këtë ne po e bëjmë këtë ngritje, që ai të blejë kontiniera.

**Alban Berisha** - a po e bëni rritjen për m' i rritë rogat,apo me ble kontinierin apo sepse ka ngritje deponia.Me 1.5 euro nuk mundemi m'i mbulu të gjitha këto.Atëherë duhet me bo rritje shumë te ekonomitë familjare për me ardhë këtu.Para se m'i ngrit çmimet, gjithmonë duhet të bëhet një analizë e saktë.A mjafton një here në javë me shku te familjet për ti mbledhur mbeturinat?A keni mendu me shpërnda kontinier të veqantë nëpër lagje ?

**Kryesuesi**- në parim ju pajtoheni me këtë projekt-rregullore,me prejashtim që po kërkoni me qenë 4.5 euro te ekonomitë familjare.

**Enver Shabani**-doktor,nuk e kemi bërë vet rregulloren.Miqtë tanë japonez e kanë parapa dhe kanë bë analiza të thukta në tri sezona.Mbulueshmëria me shërbim është 95 % .Kemi qenë të parët në nivel të Kosovë që ju e keni votu deponinë e mbeturinave inerte dhe kemi qenë shembull.Grupi punues dhe ekspertë nga Japonia e kanë konstatu që nuk e rëndon gjepin e qytetarit.Doktorr ,ju thatë që vitin e ardhshëm bie në 50 % .Unë nuk dyshoj dhe besoj që rritet në 90 % .Alban,një here në javë vijnë dhe me ardh dy here në javë,i dyfishohen shpenzimet kompanisë.Unë ju bëj ftesë me votu.

**Shefket Kolgeci** - Pse nuk e përmende çështjen e taksës komunale që ne jemi të vetmit që e paguajmë.Ne në këtë aspekt nuk po duam të ngarkojmë qytetarët.Duhet të bëhet ngritje graduale.

**Alban Berisha**-prej fillimit deri në fund jemi duke bisedu për një kosto të ngritjes së çmimeve,,atëherë u desh që të bëhet vendim vetëm për ngritjen e kostos.

**Kryesuesi** -pikën e 8-të e kemi te plani i veprimit.

**Alban Berisha** - atëherë u desh të shkruhet vetëm vendim për me ngrit çmimin.

**Enver Shabani**- ne,punëtorët e Eko Regjionin jemi mundu m'i mbështet aq sa ka pas mundësi Komuna.Ata kanë edhe një kontratë që marrin prej komunës por sa i përket kontinierave,deri më tani Komuna i ka shpërnda kontiniera qytetarëve falë,në shumë fshatra rurale kanë marrë kontiniera falë sepse kanë ardhë donacion nga Gizi gjerman.

**Selman Kolgeci** -kërkoj sqarim te neni 2 i kësaj rregullore ku thoni se kjo rregullore definon minimizimin e mbeturinave,ndarjen,ruajtjen,shkarkimin,grumbullimin,transportimin etj.Çka nënkupton me ndarje?A ka me vazhdu me një kontinier të ekonomive familjare e të bizneseve me u hudhë prapë letër,qelq,plastikë etj,siq ka qenë duke u praktikuar deri më tani?Nëse jo,si keni mendu m'i furnizu të gjitha ekonomitë familjare me kontiniera për me hudhë secilin lloj të mbeturinave nëpër kontiniera?U përmend që arsyeja e rritjes së çmimit është rritja e çmimit të naftës dhe çmimit të deponisë.Sa i përket kësaj çështje,ne sot jemi me një realitet tjetër prej vitit të kaluar.Ka qenë 1.80 litra e naftës dhe sot e kemi 1.30.Në këtë rregullore nuk është parapa që nëse bie çmimi i pagesës për këto shërbime, nëse bie nafta dhe lirohet deponia atje.Shpreso që kjo rregullore nuk po i përgatitet një operatori tjetër të dytë i cili do ti mbledhë mbeturinat në të ardhmen.Sa do ti rritet paga punëtorëve?Te çështja e tarifës për mërgimtarë,në funksion të formulës e keni fut edhe faturën e energjisë elektrike.

**Enver Shabani** - do ti paguajnë 12 euro në vit.

**Selman Kolgeci** - kjo nuk është në rregull, sepse nëse vjen 3 ose 4 herë në vit do ti paguajë 12 euro në vit. Nëse kjo rregullore e ka për qëllim me kompenzuar Eko Regjionin për humbjet eventuale, kjo nuk është forma si duhet me iu qas.

**Enver Shabani**-nga 1 janari i vitit 2024 inkasimin e merr Kuvendi Komunal i Suharekës dhe do ta shpall një tender ose me negociim do t'ia jep në këtë rast Eko Regjionit. Klasifikimi ka me fillu me 10% dhe do të fillojmë nga institucionet publike për të vazhduar me bizneset. Do të jetë në tre kategori : gjam, plastikë dhe letër. Sa i përket tarifave, nëse dikush e ofron një dëshmi që e ka pagu rrymën nën 15 euro në muaj, ai është konstatu që është në Diaspor.

**Selman Kolgeci** -nuk e treguat a ka me I dërgu kontinier kompania ekonomive familjare. A ka mi dërgu tre kontiniera? Ju po thoni që 2024 keni me hap tender me negociim dhe po thoni që ka me iu dhënë Eko Regjionit. A po mendoni që kjo deklaratë është pak e dëmshme dhe nuk është korrekte?

**Enver Shabani** - ka me qenë kompani e licencuar për menaxhim dhe transportim të mbeturinave. A ka me qenë Eko Regjioni ose x kompania, ne nuk po paragjykojmë por Komuna duhet me ja dhënë pasi ka asetet e veta 13 % dhe ka të punësuar.

**Flamur Bytyçi** - e kam të paqartë këtë. Meqenëse Komuna veq i ka 13 %, pse ne duhet prap me hap një thirrje për tender për me apliku dikush tjetër? Meqenëse kemi aksione dhe kemi investu aty kohë pas kohe, ne duhet me mendu si me fuqizu atë ndërmarrje.

**Qëndrim Elshani**-lexon një mezash të sapo ardhur të një qytetari ku thotë se këtu te ne mbeturinat nuk menaxhohen por vetëm grumbullohen dhe hudhën në vendin e caktuar. Për deri sa nuk ka një plan konkret se ku kanë me shku kjo rritje e çmimit, unë ftoj gjithë anëtarët e Kuvendit që mos të votohet.

**Urim Suka**-unë po ju kuptoj. Ai që ju ka dhënë urdhër që ta bëni 6 euro nuk është këtu dhe ju po mundoheni me mbrojtë propozimin e atij. Ju thatë rrogat, ju thatë shumë mendime për me arsyetu atë që doni ta bëni por asnjëra nuk po qëndron. Ju kisha lut me kthi në nivelin ku jemi. Propozimi jonë është vetëm për njesitë familjare dhe ju them ta votoni propozimin tone dhe ta kalojmë këtë rregullore.

**Kryesuesi** - e hedhë në votim propozimin e pare që vlera të jetë 6 euro.

10 për, 13 kundër, 1 apstenim  
Nuk Miratohet

**Kryesuesi** - e hedhë në votim propozimin e grupit të LDK-së.

11 për, 15 kundër, 1 apstenim  
Nuk Miratohet

8.

**Kryesuesi** - i njofton me pikën dhe hap debatin.

**Selman Kolgeci** -nëse e analizojmë këtë plan Komunal për menaxhimin e mbeturinave te pika 1.1, „korniza institucionale për menaxhimin e mbeturinave keni deklaruar se drejtoria për punë inspektuese është përgjegjëse për mbikqyrjen dhe zbatimin e ligjeve dhe dispozitave ligjore por dua t'ua rikujtoj se kjo drejtori ka qenë e obliguar edhe më herët ti mbikqyr dhe t'i monitoroj kundërvajtësit që i hedhin mbeturinat në vendet ku një veprim i tillë është i palejueshë, por kjo mbikqyrje e ky monitorim ka qenë larg. Po ashtu disa kompetenca në këtë plan të menaxhimit të mbeturinave i adresohen ndërmarrjes KRM “Pastërtia” e cila operon në Ferizaj dhe Kaçanik. Nuk e kam të qartë se pse ky pasqyrim ndodhet në këtë. Në këtë dokument marshuta e lëvizjes së automjeteve transportuese me kontinier nuk është rritur, as litrat e naftës nuk janë rritur. Nëse nuk janë rritur këto elemente, pse keni dasht me dëmtu buxhetin e qytetarëve. Nga 12.109 ekonomi familjare, rritja prej 1.5 për shtëpi rezulton 18,163.50 cent në muaj e që në vit I bie 217,962.00 euro. Ndërsa nga të dhënat që i keni ofruar për masën e mbeturinave që mbledhen dhe dorëzohen, mjetet transportuese i shpenzojnë rreth 70.000 l karborant dhe kjo nuk është arsyeja me ja marrë 217 euro qytetarëve më shumë për 70.000 l naftë që i keni pagu deri tash. Po ashtu nuk po e shoh që mbetjet medicinale nga ordinancat private nuk është planifiku si me i menaxhu.



**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 8.

**14 për, 1 kundër, 9 apstenime**  
**Miratohet pika 8**

## **9. Pyetje dhe përgjigje**

**Kryesuesi** - jep sqarime për mos prezencën e Kryetarit. Hap debatin për pikën 9.

**Urim Suka** - mbledhjen e kaluar kam bërë një pyetje për Drejtorinë e Arsimit dhe nuk kam marrë përgjigje edhe pse drejtori është zotuar se do të jep përgjigje. Pyetje për Drejtorinë e Arsimit- ditët e fundit kemi pa një përpjekje të Kryetarit përmes përdorimit të fëmijëve, përkatësisht nxënësve, të krijoj një imazh pozitiv për veten e tij, madje edhe duke orkestruar surpriza me skenare të parapërgatitura mire. Sot unë dua të jem zëri i të gjithë atyre studentëve që kanë përfunduar studimet e tyre dhe konkurojnë në konkurse që DKA shpall për rekrutimin e mësimitdhënësve si dhe zëri i atyre mësimitdhënësve që nuk po i merren parasysh kërkesat e tyre për plotësim norme apo sistemin në vendin e punës. Gjatë këtyre ditëve kam pranuar shumë shqetësime nga shumë student që kanë aplikuar në këto konkurse e po ashtu kam marrë shqetësime edhe nga mësimitdhënësit që nuk iu keni dhënë të drejtën për plotësim norme e sistemin të vendit të punës. Për mua është e papranueshme dhe e çuditshme se si po rekrutohen mësimitdhënësit nga ky pushtet. A mund të më tregoni se si ka mundësi që në disa raste keni angazhuar mësimitdhënës pa shpallur konkurs fare. Konkursi është shpall pas rekrutimit të tyre dhe pastaj të njëjtit janë zgjedhur. A mund të më tregoni se pse po ndodhë një dukuri e tillë dhe a jeni të vetëdijshëm për dëmin që shkaktohet nga kjo mënyrë e pa përgjegjshme e sjelljes tuaj? A mund të më njoftoni se pse nuk po i merrni parasysh disa kërkesa të mësimitdhënësve për sistemin të vendit të punës apo plotësimin e normave të tyre, ndërsa për disa që janë të rrethit tuaj të ngushtë, një gjë e tillë po respektohet. Pyetje për Drejtorinë e Bujqësisë: këto ditë kam marrë shumë shqetësime qytetare për rrezikun nga qentë endacak. Për vitin 2021 Komuna ka planifikuar 20 mijë euro për trajtimin e qenëve endacak ku ka hapur një procedure tenderimi por për shkak të keq menaxhimit të këtij procesi, kjo çështje ka përfunduar në OSHP dhe për shkak se OSHP në atë kohë ka qenë jo funksionale, ky planifikim ka dështu. Ndërsa gjatë hulumtimit pashë që edhe në vitin 2022 ky pushtet kishte planifikuar 15 mijë euro dhe kishte hapur një procedure tenderimi për të cilën kishte hartuar kritere për favorizimin e një operatori ekonomikë, ku si rezultat edhe kjo lëndë ka përfunduar në OSHP e rrjedhimisht ishte pezull nga ky pushtet. A ndiheni përgjegjës për dështimin tuaj që nuk keni arritur që për dy vite të bëni trajtimin e qenëve endacak e rrjedhimisht përmes kësaj është rritur numri i tyre në teren dhe rreziku për qytetarët, veqanërisht për fëmijët. Cili është planifikimi juaj për vitin 2023 për këtë çështje. A do të dështoni prapë duke provuar të diktoni fituesin e tenderit apo do të ndiqen procedurat ligjore. Për ndërtimin e rrugëve në fshatin Samdraxhë, ju keni lidhur një kontratë që sipas jush është 2 vjeqare me datë 10.06.2022, ku janë planifikuar ndërtimi i rrugëve: Vatra, Dodona, Molla e Kuqe, Gjev Lladroci-vazhdim, Demir Demiraj-vazhdim, Bahri Fazliu, Fehmi Agani-vazhdim, Fatmir Bylykbashi, Bregu i Jazit, Jeton Kabashi-seg, Gusia, Mulla Idriz Gjilani, Vaqe Zela, Pashtriku, Lulzim Bylykbashi-seg dhe Feim Morina-seg. Në bazë të informatave që kam, nga 16 rrugët e kontraktuar janë përfunduar vetëm dy, rruga Dodona dhe Gusia ku janë shpenzuar 90 mijë euro nga 178.434 euro sa janë gjithsej, ndërsa në disa rrugica keni vendos zhavorr por rrugët nuk janë rregullu. Cili do të jetë fati rrugëve që janë të pashtuara dhe figurojnë në kontratë? A mund të më sqaroni se pse rrugët që janë në kontratë dy vjeqare nuk figurojnë në planifikimin e viti 2023? Cilat rrugë do të ndërtohen tani për vitin 2023?

**Remzi Bajselmani** - personalisht me përgjegjësi them se përpiqem maksimalisht që procesi në K. Suharekës të shkoj mirë dhe gjë që vitin e kaluar është vlerësuar maksimalisht. Sa i përket pyetjes, disa shkolla kanë sjell kërkesë për ti vizituar institucionet komunale dhe në lëndën e edukatës qytetare është e paraparë që të vizitohen institucionet komunale. Është vizituar policia e Kosovës, Komuna e Suharekës, Gjykata, Muzeu dhe institucione që janë në Komunë. Te pyetja për rekrutimin e mësimitdhënësve, janë procedura ligjore që shpallen dhe janë publike ku formohen komisione të cilat e marrin përgjegjësinë për rekrutim. Nga një lëndë ka kërkesa shumë dhe konkurenca është e madhe por një do të merret dhe

pakënaqësi mund të ketë.Sa i përket sistemimit të mësimdhënësve,me përgjegjësi them se për të gjithë kemi qenë të barabartë dhe me përgjegjësi them se asnjë kërkesë nuk e kemi për plotësim norme.

**Urim Suka** - sa i përket rekrutimit,unë i kamë 7-8 raste dhe mund ti them me emra dhe mbiemra që i ke rekrutu dhe pastaj e ke shpall konkursin dhe i ke shpall fitues po ata.Ju nuk më dhatë përgjigje.Te pjesa e sistemimit,unë e di me emër dhe mbiemër kërkesat që i ke në zyrën tënde dhe nuk i ke kthy përgjigje fare. Unë e di me emër dhe mniemër se kush do të pranohet aty.

**Ardian Kotorri** - e kuptoj shqetësimin e asambleistit Suka.Ne realisht buxhetin që e ndajmë për qentë endacak është i pa mjaftueshëm,nuk e zgjidh problemin në tërësi por megjithëatë bëhet një përpjekje e institucionit.Në vitin 2021 një kontratë ka shkuar në OSHP dhe është e vërtetë.Në atë kohë ska pas OSHP dhe lënda ka mbet si ka mbet.Në moment që ka përfund, lënda ka ardh si procedure e Komunës që me pas të drejtë me hap një tender të ri.Ne i kemi fillu procedurat por për fat të keq para se ta bënin ofertimin kompanitë,një ofertues i ka dërgu kushtet në OSHP.Realisht ne ato kushte qe 7-8 vjet si procedure i dërgojmë të njejtat dhe nuk ka pas asnjë favorizim apo diçka tjetër dhe jemi shqetësuar për këtë që po ndodh.Edhe për këtë vit kam planifiku buxhet dhe nuk po mund ta nis procedurën për shkak se lënda për momentin është ende në OSHP.Drejtori tutje jep sqarime dhe thotë që problemi i qenve endacak është kombëtar.Mumdeni me zgjedh një temë tjetër për politikë sepse këtu nuk bëhet politikë.

**Urim Suka** -drejtori u mundu me sulmu këndeje por nuk dha asnjë përgjigje.Drejtori e vërtetoi atë që thashë unë,që dy vite njerëzit nuk kanë marrë shërbime për me e trajtu këtë çështje,dhe këto shërbime nuk janë marrë për shkak të kriterëve që këta kanë provu me i vendos për me favorizu dikënd.

**Ardian Kotorri** -unë jam thellësisht i shqetësuar me metodën e të bërit politikë në këtë formë.Unë kur kam ardhë e kam gjetë një lëndë të vitit 2021 në OSHP dhe unë nuk kam mundur ta nis procedurën deri gjysmën e viti për shkak se lënda ka qenë në OSHP.

**Enver Shabani** -informatat që i ka Urimi unë nuk i kam sepse nuk jam menaxher i kontratës por tash e mbas do të kujdesem dhe do të marrë informata shtesë dhe nëse ka nevojë përgjegjën ia jap seancën e ardhshme.Sa i përket rrugëve në Samadraxhë,të gjitha rrugët që janë pa asfalt do të shtrohen me asfalt dhe me kubëza.

**Urim Suka** - nese Drejtori i Shërbimeve Publike nuk i ka iformatat për ndërtimin e rrugëve në Samadraxhë,kush duhet me i pas?Fatkeqësia më e madhe është se prej atyre rrugëve që nuk janë shtruar në Samadraxhë,nuk figurojnë në planifikimin e këtij viti.Urojmë që drejtorat të punojnë më shumë dhe ti kenë informatat.

**Kushtrim Kuçi** -kam një shqetësim nga prindërit e fshatit Gjinoc për fëmijët e tyre.Bileta e nxënësve të shkollave të mesme është 0.80 cent.A do të ishte e mundur që ne si Komunë të bëjmë diçka në këtë drejtim ose me bisedu me kompanitë e autobusave që ti marrin parasysh së paku nxënësat e shkollave të mesme.Gjithëashtu kjo vlen edhe për studentët,ose ti subvencionojmë këto kompani.Duke i marrë parasysh kushtet që jemi duke jetuar,besoj është shumë për këtë transport.

**Kryesuesi** - e vetmja mënyrë është me bisedu me atë kompani e cila operon në atë relacion,e cila është "Xhati tours",kurse sa i përket subvencionimit,ajo shtë çështje e Kryetarit sepse ai hyn në biseda me ta por nuk e besoj që kryhet sepse është çmimi i tregut.

**Shefket Kolgeci** -pyetje për Drejtorinë e Kulturës: Shtëpia e Kulturës "Ukë Bytyç",a kemi shpresë që do të rregullohet ndonjëherë? E di që ka kalu në OSHP.A është bënë diçka,a ka fillu ri-tenderimi për tu bënë kjo shtëpi ndonjëherë funksionale?

**Lorika Gashi** - ky është shqetësim edhe i joni dhe i qytetarëve.Ka kalu në OSHP,është ri-tenderu përsëri dhe tash për momentin është në procedurë të vlerësimit.

**Qëndrim Elshani** -Pyetje për Drejtorinë e Shëndetësisë: seancën e kaluar kam pyetur se pse nuk ka biokimist dhe Kryetari është përgjigj se kemi hap konkurs dy herë dhe nuk është përgjigj askush.Me aq sa kam kërku unë,nuk kam pa asnjë konkurs gjatë qeverisjes së Bali Muharremaj.Me aq sa kam pa unë, konkursi i fundit ka qenë në kohën kur Kryetar ka qenë Sali Asllanaj.Ku mundem me gjetë konkursin që e ka thënë Kryetari?Pyetje për sektorin e Arsimit:kam shqetësime prej disa qytetarëve që kanë aplikuar për një vend pune në "7 Marsi"ku po supozohet që ka me pas trashëgimi familjare në të njejtën pozitë që dikush ka qenë më herët.A po përgaditet një gjë e tillë apo shqetësimet e qytetarëve janë të kota?

**Besa Kuçi** - unë ju informoj që sot është ri-shpall konkursi për 40 vende të reja të punës për punëtor shëndetësor,ku një ndër ato pozita është edhe një specialist i biokimisë.

**Qëndrim Elshani** - pyetja ishte se a është e vërtetë ajo që ka thënë Kryetari?

**Besa Kuçi** - unë mund të them që në mandatin tim nuk u shpall dhe për mandatet tjera nuk e di.

**Festë Kabashi**-javët e fundit,ndoshta kemi pasur rastin të informohemi në lajme për rastet e evidentuara si pasojë e ngacmimeve seksuale në institucionet e arsimit parauniversitar.Sipas të dhënave të fundit 34 % e shkollave në nivel vendi ballafaqohen me ngacmime seksuale.Ajo që e rëndon gjendjen edhe më shumë,është fakti që kjo përqindje vjen vetëm si evidentim i rasteve të raportuara në polici nga mediat e jo si evidentim i rasteve të raportuara nga shkollat.Kjo na bënë përveq se ta kuptojmë po ashtu edhe ta pranojmë se tashmë është bërë praktikë që institucionet tona edukativo-arsimore qëllimisht tentojnë ti minimizojnë e ti heshtin rastet e kësaj natyre që po ndodhin në shkollat ku ata po udhëheqin dhe po punojnë.Nisur nga kjo,nëse duam ta bëjmë një hap para, sipas mendimit tim roli i këshillit të nxënësve është thelbësor.Ne e dimë që udhëzimi administrative parash që këshilli drejtues i çdo shkolle obligohet të themelojë këshillin e nxënësve,i cili përbëhet nga një nxënës prej secilës klasë.Me aq sa kam informacion, po flas për shkollat rurale,ky këshill është tejet pasiv e madje as nuk ekziston si organ brenda shkollës.Pyetja ime drejtuar Drejtorit të Arsimit është: a jeni të gatshëm që të ndërmerrni hapa konkret me qëllim që ta ri-funksionalizoni këtë këshill të domosdoshëm nëpër shkollat tona? Që praktikisht nënkupton që përfaqësuesit e nxënësve të mbledhen çdo muaj,ti paraqesin shqetësimet e tyre dhe të mbajnë procesverbale të rregullta.Pyetja dytë ka të bëjë me angazhimin e psikologëve nëpër shkolla.Sa po sjellë rezultat puna e tyre nëpër shkolla?Pyetja e tretë:keni kërkuar prej shkollave nga dy propozime mësimdhënësish për ciklin e ulët dhe të lartë për të fituar mirënjohje si mësimdhënësi më i sukseshëm për nder të festë së 7 Marsit.A mendoni se shkollat e kanë bërë përzgjedhjen e duhur brenda kolektivëve të tyre dhe në përputhje me kriteret që ju i keni listuar?Po ashtu për dy kriteret kryesore,që më vjen mire që i keni përfshirë dhe që janë opinionet e nxënësve dhe të prindërve.Në çfarë forme do të dokumentohen ato nga mësimdhënësit dhe si arrihet deri tek përzgjedhja finale e mësimdhënësit më të mire?Apeloj që të keni kujdes më të shtuar se kënd po e përzgjedhim më të mirin dhe pse.

**Remzi Bajselmani** - shkollat kanë obligim që të formojnë këshillat e nxënësve dhe të gjitha shkollat e dorëzojnë listimin e tyre.Ne si komunë kemi bërë mjaft për sigurinë nëpër shkolla.Përveq bordeve të shkollave,drejtori ka obligim të formojë edhe këshillat e sigurisë,e që janë formu dhe janë efektiv.Në çdo shkollë jemi përpjek të kemi psikolog shkolle,që 90 % janë femra,gjë që e lehtëson pjesën e ngacmimeve për të cilat u cek më lartë.Është mbajtur trajnim special me këtë kategori,kështu që ne kemi informatat pozitive për punën e psikologëve nëpër shkolla.Te mësimdhënësi i dalluar,është një rregullore të cilën e kemi shpërnda në çdo shkollë.Shkollat janë obligu që të zgjedhin mësimdhënësit në këshillin e arsimtarëve në bazë të performances që ka tregu për një vit mësimor.Drejtori tutje jep sqarime rreth përgjedhjes së mësimdhënësit më të mirë.

**Festë Kabashi**- unë e di që proceduralisht është ajo çka thatë por pyetja ime ishte se sa është korrekte përzgjedhja.Ju si drejtori, sa kërkon raport,sa keni interes,sa shqetësim?Unë më shumë e kam shqetësimin tek funksionimi i këshillit të nxënësve,duke marrë parasysh temën për ngacmime seksuale. Unë e di që ky këshill në disa shkolla nuk është aktiv dhe unë nuk mendoj që është faji juaj.Unë po kërkoj prej jush një kërkim të raportimit që ju drejtor shkolle-mësimdhënës-nxënës me funksionu pak më mire.

**Remzi Bajselmani** - janë funksionale për aq sa kemi ne informacion.

**Festë Kabashi** -pse pra po ekzistojnë këto raste të ngacmimeve seksuale dhe problematika të tjera nëse gjithëçka po funksionon si duhet?

**Flamur Bytyçi** -e kam një porosi për Kryetarin,se në mbledhjen e kaluar kam bërë një vërejtje për një raport që nuk më është dorëzuar prej Drejtoreshës së Inspeksionit, që gati është muaji i tretë.Po të njoftoj që nuk bëj lutje më por ka me ndërmarrë masa tjera.Pyetje për Drejtoreshën e Shëndetësisë:në muajin e kaluar ka qenë një rast i një fëmiju që ka marrë një barnë në QKMF në Duhël.Çfarë masa keni ndërmarrë,si ka ndodhë ky rast që ka mundur ta merr një barnë të tillë në QKMF?

**Albulena Kokollari** -vërtetë u bë e përsëritshme kjo pyetje edhe pse unë kam dhënë sqarim.Kush do që e bën këtë pyetje,përgjigja ka me qenë e njejtë.Raporti vjetor që e ka bërë Drejtorja e Inspeksionit është në web faqe.Çdo gjë që ju intereson,jo vetëm ju por edhe gjithë qytetarëve është në web faqe.

**Flamur Bytyçi** -kur i bëjmë pyetje drejtorave të tjerë,pse po na përgjigjen apo vetëm ju jeni e veçantë.

**Besa Kuçi** - ky rast ka qenë mediatikë dhe e keni pa që është një gabim i pafalshëm i punëtorëve shëndetësor që kanë qenë në ndërrim dhe që e kanë dhënë barin me afat të skaduar.Përveq që ka qenë ky gabim shkelje e deturave të punës,ka qenë edhe pak tendencioz publikimi.Të nesërmën inspektoriat farmaceutik ka dalë në vendin e ngjarjes,i ka intervistuar doktorin dhe infermierin dhe ata me një procesverbal i kanë dënuar doktorin dhe infermierin me një gjobë rreth një mijë apo dy mijë euro.Drejtoresha tutje jep sqarime dhe thotë që po e presin raportin e inspektoriatit dhe çka do që vjen nga inspektoriat,menaxhmenti i QKMF-së është i detyruar të marrë masa konform ligjit.

**Flamur Bytyçi**-si ka mbërri ky bar me shku pa afat?

**Besa Kuçi** - ky bar nuk ka shku pa afat dhe është përgjegjësi ekskluzivisht e infermierit që e merr prej raftit dhe ia jep pacientit.Drejtoresha tutje jep sqarime dhe gjithëashtu thotë që nuk ka dilemë këtu që nuk denohet askush.

**Flamur Bytyçi** -problem im është se si ka dalë prej depos qëndrore?

**Besa Kuçi** - unë ta sqarova që nuk ka dalë prej depos qëndrore pa afat.Ne mundemi me i shiku proceset dhe kërkesat se kur ka shku ai bar,por ju siguroj që ka shku me afat.Drejtoresha tutje jep sqarime.

**Selman Kolgeci**-Pyetje për Drejtorinë e Inspektoriatit:A e dini që për shkak të mos veprimit tuaj mund të shkoni në përgjegjësi.Të është kërkuar lista e inspektimeve të drejtorisë suaj nga kolegu jonë Flamuri dhe prap po insistoni që ne ta marrim në web faqe.Ne nuk e kemi obligim me patrullu nëpër web faqe të komunës.Ato që i kërkojmë,e keni obligim ligjor me na sjellë këtë informatë.A e dini sa ndërtime pa leje dhe sa mbindërtime po ndodhin para syve tu?Ne e dimë dhe nuk po merr asnjë masë.Nëse nuk jeni e gatshme me vepru,po ta them sinqerisht,mos ia merr pagën çdo muaj qytetarëve nga taksat e tyre.Pyetje për Drejtorinë e Urbanizimit:A keni planifikuar se sa inspektor të ndërtimeve duhen për ta përcjellë implementimin e projekteve të objekteve ndërtimore që kanë filluar e do të fillojnë në qytetin tonë?Vetëm një inspektor ndërtimi nuk mund të përcjell ndërtime,të kalimet e lejeve ndërtimore,mbindërtimet e të ngjajshme.Kam një kërkesë nga disa qytetarë në Bukosh dhe Dvoran për disa ngadalësues të shpejtësisë(police të shtrirë).Përgjigjen që keni kthyer është se nuk ka kontratë dhe nëse mundeni me i vendos, vendosni vet.Tash ka kontratë dhe në atë kontratë e kam pa që ekziston edhe ky pozicion i ngadalësuesve të shpejtësisë.Nëse e shihni të arsyeshme,shkoni dhe vendosni dhe nëse jo,arsyetone në KKSB që të marrin masa tjera për me zvogëlu shpejtësinë e lëvizjes në vendet që ata kanë bërë kërkesë. Qështja tek rreth rrotullimi të shtëpia e Kulturës.Dua ta falemderoj donatorin që e ka rregulluar atë rrethrotullim.I kanë heq shenjat e trafikut aty dhe nëse merret për tu shqyrtu një ekspertizë,nuk e din a ka me trajtu si rreth rrotullim atë apo jo.Nuk ju kushton shumë,3-4 shenja të trafikut dhe e rregulloni këtë problem.Pyetje për Drejtorinë e Arsimit:po e shoh që po aplikoni një praktikë të shpalljes së vendeve të lira të punës dhe punësimit e mësimdhënësve për lëndë të caktuara që mund të mbulohen nga mësimdhënësit që veq kanë kontratë por nuk kanë normë të plotë.Akoma pa e plotësuar normën një mësimdhënësi,ju po shpallni konkurs për me marrë një mësimdhënësi tjetër. Po bëhet fjalë për një mësimdhënësi të edukatës fizike.Pse nuk po ia plotësoni normën mësimdhënësve që janë aktiv?Pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike:E kemi kontratën aktive për mirëmbajtje të rrugëve.A mund të na shpjegoni se pse nuk po i riparoni gropat e rrugëve nëpër qytet dhe nëpër fshatra?E di që zyrtarisht fillon me 15 mars sezona por ke pas kushte klimatike me fillu edhe më herët.Te hyrja e tregut me muaj të tërë është bërë një ndërhyrje atje dhe kanë vështirësi automjetet me kalu.Çështja tjetër është te rrethrotullimi te stacioni i policies.E di që është problem çështja e tensionit të lartë por së paku mi asfaltu ato pjesë që i keni gërmu.Pyetje për Drejtorinë e Shëndetësisë:kam informata nga qytetarët që po mungojnë gjanat elementare në Bukosh,Duhël e Studenqan.Si po qëndron furnizimi me barna në QMF-të?Pyetje për Drejtorinë e Kulturës..A i kanë përfunduar projektet të gjitha OJQ-të,projete të cilat kanë marrë mbështetje nga drejtorja juaj?Nëse po,a mundeni me na hartu një raport me të gjitha detallet?

**Albulena Kokollari** - pyetjes i dha vet përgjigje ndërsa për lejet është urbanizmi.

**Visar Kuçi** -adresove çështjen e inspektorëve të ndërtimit.Nuk është kompetencë e Drejtorisë së Urbanizmit.Drejtoria e Urbanizmit i pais palët me leje dhe në moment që paiset pala me leje,një kopje e lejës shkon në Drejtori të Inspeksionit.Dhe për mua është shqetësuese sepse në këtë drejtori është vetëm një inspektor i ndërtimit,të cilët me ligj të ri kanë shumë kompetenca.Drejtori tutje jep sqarime rreth kësaj çështje.Sa i përket pyetjes për polic të shtrirë në Dvoran,qytetarët kur të bëjnë kërkesë për polic të shtrirë, nëse ne kemi buxhet dhe e parashohim që është e nevojshme,ia kthejmë dhe në përgjigje,që marrim masa. Kemi raste kur ne nuk kemi buxhet dhe pajtohemi me qytetarin dhe ka raste që qytetari e vendos vet.Në këtë rast ne jemi në përfundim të vlerësimit dhe nuk kemi lidhë ende kontratë.

**Selman Kolgeci** - te Drejtoresha e Inspeksionit nuk mora përgjigje se sa ndërtime pa leje janë tu ndodh dhe mbindërtime.Tek çështja e inspektorit,unë e di që nuk është kompetencë e juaja,por thashë që në bazë të lejeve që ju i lëshoni,a është i mjaftueshëm një inspektor.Ju u pajtuat që nuk është e mjaftueshme.

**Remzi Bajselmani**-pjesa më shqetësuese dhe më sfiduese është pjesa e konkurseve.Ne konkurset i hapim kur shkolla kërkon:me rastin e pensionit të një mësimmhënësi ose në pushimet e lehonisë.Ne i analizojmë punëtorët që janë dhe atëherë konstatojmë kur me u shpall dhe kur mos me u shpall.Një procedurë për tu shpallur një konkurs kërkon së paku 45 ditë.Aktualisht i kam dy drejtor që janë duke mbajtur mësim për shkak se arsimtari është sëmurë dhe është operu.Ne nuk kemi në arsim njerëz që rrinë të gatshëm dhe kur të ndodh diçka me i kyç por duhet me zhvillu procedura sepse jemi të imponuar ti bëjmë këto konkurse gati çdo muaj ,nga një.Janë të mundimsh,edhe për stafin edhe për ne por detyrohemi.

**Enver Shabani** - është e vërtetë që disa gropa janë kriju por janë 3 ose 4.Ne i kemi tri kontrata të hapura që ne i kemi menaxhuar gjatë kësaj periudhe kurse në kontratat tjera dy vjeqare,nuk kanë funksionu sepse po arsyetohen që në këtë kohë nuk bënë baza e asfaltit.Dje zyrtarisht të gjithë operatorëve ekonomikë që kanë kontratë dy vjeqareia kemi dërgu nga një email dhe duke marrë për bazë motin e mire,i kemi thënë që të fillojnë me punët që në javën e parë të marsit.Sa i përket rrethrotullimit,aty gypat kanë hy nën tokë dhe po presim veq mu bartë kabllat nga lartë me hy në tokë dhe me u rregullu edhe çështja e asfaltit.

**Besa Kuçi** - këto shqetësime i kam edhe unë,i ka edhe QKUK-ja,i ka spitali regjional I Prizrenit.Pasi që planifikimi shkon prej QKMF-së në SIMFK në Ministri të Shëndetësisë,ku bëhet furnizimi me barna dhe material shpenzues.Deri më tani sipas të dhënave që kam nga depo qëndrore,furnizimi me barna nga Ministria e Shëndetësisë është bërë vetëm 60 % kurse me material shpenzues është bërë 80 % që pjesën tjetër ne e mbulojmë me një kontratë aktive.Furnizimet me QMF,AMF,QKMF,Urgjencë,gjithmonë shkojnë në bazë të kërkesave të cilat bëhen nga personat përgjegjës dhe në bazë të kërkesave furnizohen. Drejtoresha tutje jep sqarime.

**Lorika Gashi** - kërkoj falje që t'kam mbet borgj në përgjigje.Java e artit është aktiviteti që organizohet nga një organizatë private.Nuk kam pas një kërkesë për një projekt të tillë gjatë vitit të kaluar.Disa nga artistët e asaj oganizate janë përkrah në mënyrë individuale.Kush do që e mbështet kulturën i falenderoj.Raportin do ta sjellim gjatë javës së ardhshme.

**Selman Kolgeci** - korrekte për me na i sjell dokumentacionet dhe e falenderoj publikisht.Unë i kam tri kërkesa që t'i kanë adresu ty për javën e artit dhe e di që nuk është date e shënuar në kalendarin e Drejtorisë së Kulturës por nuk keni shumë aktivitete dhe keni mundur ta përkrahni.

**Lorika |Gashi** - e thashë.Nga artistët në fjalë që i takojnë asaj OJQ-je,janë përkrah individualisht dhe sa kanë pas dëshirë ata me vazhdu projektin ose ka pas edhe nga ata që e kanë refuzu projektin por kjo nuk është në kompetencat e mia.Drejtoresha tutje jep sqarime.

**Selman Kolgeci**- shpresoj të kemi javë teatri por ti dhe Kryetari jeni fajtor që e keni lënë qytetin pa teatër e qytetarët pa shfaqje.Çka është përkrah?A është mbajtur një javë e artit këtu?Disa janë përkrah dhe disa kanë refuzu.Cila është arsyeja që ata kanë refuzu?

**Lorika Gashi** - sa i përket teatrit nuk ndalem me të kundërshtu sepse nuk është faji as i Kryetarit dhe as i askujt sepse është diçka që nuk bëhet.Sa i përket temës me të cilën ti lidhesh me teatrin,ajo është temë e ulët.Sa i përket javës së artit,java e artit nuk ka ardhë nga një organizatë,pjesëtarët e asaj organizate kanë ardhë në mënyrë individuale.

**Selman Kolgeci** - pyetja ishte:a u përkrah,kush u përkrah dhe nëse u përkrah ,a u mbajtur ai aktivitet?Pse çështje e ulët me bisedu për teatër!Nëse ju aludoni që unë po diskutoj mbi bazën e një ekcesi që ka ndodh

këtu,e keni shumë gabim dhe kërkoj ta tërhiqni fjalën.Po,ju jeni fajtor pse nuk kemi sot teatër.I keni rekomandimet e ministrisë së kultures por nuk jeni marrë me ato rekomandime.Ju keni dështu.

**Urim Suka** - gjatë seancës më shkruajti një qytetarë dhe çështja ishte te shitësit ambulant të luleve në kuadër të festave të 7 dhe 8 Marsit.Një tregtare e ngriti si shqetësim,që ka fillu me u shit nëpër rrugë dhe kërkoj që kjo çështje me u ngrit këtu,te Drejtoresha e Inspeksionit dhe ta kenë parasysh që këta që paguajnë tatime me pas një fare të drejte dhe jo me iu bë konkurrencë.Dua të lidhem te qështja kur dëgjova Drejtoreshën kur e akuzoj qytetarin që e ka denoncu rastin.Përkundrazi unë e mendoj të kundërtën.Ai qytetarë e ka bë punën më të mire të mundshme që e ka denoncu dhe drejtoresha duhet me tërheq atë fjalë.Drejtori i Arsimit u mundu me më dhënë përgjigje ma konkrete dhe unë e falemderoj por po i them si mik,që rekrutimi i mësuesave para se me u hap konkursi,është shkelje ligjore.Te pjesa e pushimeve të lehonisë,ato janë të planifikueshme ndërsa te pjesa e pushimeve që nuk janë të lehonisë,aty ke të drejtë pak a shumë.

**Besa Kuçi** - ju lutem mos i devijoj fjalët që unë flasë.Edhe pa u publiku raste ka pas raste kur Besa ka suspenduar persona të caktuar,ka dërgu në komisione disiplinore,ka dhënë vërejtje.Nuk e akuzova qytetarin.Unë thashë që të njejtën kohë përveq se është shkelje flagrante e detyrave të punës por në të njejtën kohë ka qenë edhe tendencioze.Është fat i mire që fëmja është mire.

**Remzi Bajselmani** - çështja te pushimet e lehonisë planifikohet.Këtë vit shkollor 11 mësimdhënës kanë marrë leje dhe kërkojnë pushim pa pagesë.Vetëm kur ti vje viza ata lajmërojnë dhe e lënë klasën.Këtu jemi detyru me tejkalu veten ndonjëherë sepse e din ndjeshmërinë.

Takimi përfundoi: 13:15

Procesmbajtësja: Dafina Haziraj